

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data : 05.03.2019]

Për: Operatorin Ekonomik “Alb Tiefbau” sh.p.k, me NIPT J66703049C, me adrese: Lagjja Qemal Stafa, Rruga Studenti, Sheshi 2-Prilli, pallati Fishta 2, zona kadastrale 8591, nr pasurie 2/988-N8, Shkodër.

Procedura e prokurimit: “Tender i Hapur” me objekt : “Rikonstruksioni i Rrugës Balldre - Bend Bashkia Lezhë”.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Rikonstruksioni i Rrugës Balldre - Bend Bashkia Lezhë”.

Numri i referencës së procedurës: **REF-89964-10-15-2018.**

Kohëzgjatja: brënda 9 muajsh nga data e fillimit te punimeve.

Fondi limit: 372.504.453 (treqind e shtatëdhjetë e dy milion e pesëqind e katër mijë e katërqind e pesëdhjetë e tre) lekë pa tvsh.

Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **Datë 15.11.2018.**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Nuk ka patur.

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara pa tvsh:

NR	SHOQERIA	OFERTA PA TVSH PARA KONTROLLIT ARITMETIK	NIPT
1	"GPG" SHPK	246,625,652	J64324443V
2	"SMO UNION" SHPK	247,709,531	J66902042Q
	"SHKELQIMI 07" SHPK		K68121808W
3	"LALA" SHPK	257,344,134	J76418903B
	"ED KONSTRUKSION" SHPK		K61625001I
	"JODY KOMPANY" SHPK		J94824803M
	" SHANSI INVEST" SHPK		J61924002T
4	"B 93" SHPK	258,773,147	J62903508R
	"RIVIERA" SHPK		J66903244D
	"BOSHNJAKU B" SHPK		K72627402H
5	"GJOKA KONSTRUKSION" SHPK	260,753,646	J91815014U
6	"DELTA LAVORI" SHPK	273,518,517	L62415021P
	COMPANY RIVIERA 2008" SHPK		K81716011V
7	"ALBA KONSTRUKSION" SHPK	278,255,453	J61812013R
8	"4AM" SHPK	286,666,269	K92005016L
9	"BE IS" SHPK	310,992,912	K71412003A
10	"CURRI" SHPK	316,340,450	J67902718S



FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
ALBANIAN DEVELOPMENT FUND

11	"ALB TIEFBAU" SHPK	316,628,785	J66703049C
12	"JUNIK" SHPK	330,958,662	J68007522L
13	"VELLEZERIT HYSA" SHPK	341,106,765	K12911201C

Pas vleresimit te dokumentacionit te paraqitur komisioni me unanimitet vendosi:

1. Te skualifikoje Operatorin Ekonomik “GPG” shpk pasi:

Nuk ploteson kerkesen 2.3.9 dhe 2.3.10 per kualifikim lidhur me disponimin e mjeteve dhe paisjeve, pasi nuk disponon mjetin “Mikser Rrotullues (Rotary Mixer)”. Ne vend te paisjes se kerkuar ne specifikimet teknike per kete qellim, kjo shoqeri ka paraqitur nje betoniere kantieri e cila nuk ka asgje te perbashket me mjetin e kerkuar. Duke qene se mjeti i kerkuar ne kerkesat per kualifikim, referuar edhe specifikimeve teknike te ngarkuara ne sistem, eshte i domosdoshem per realizimin e punes sipas teknologjise se re te parashikuar ne projekt, kjo shoqeri nuk mund ta kryeje punen qe tenderohet.

Duke qene se kjo e mete eshte thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete shoqeri.

2. Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomike “SMO Union” shpk (46%) dhe “Shkelqimi 07” shpk (54%) pasi:

Bashkimi i Operatoreve Ekonomike nuk ploteson kerkesen 2.3.9 dhe 2.3.10 per kualifikim lidhur me disponimin e mjeteve dhe paisjeve, pasi nuk disponon mjetin “Mikser Rrotullues (Rotary Mixer)”. Ne vend te paisjes se kerkuar ne specifikimet teknike per kete qellim, kjo shoqeri ka paraqitur nje betoniere kantieri e cila nuk ka asgje te perbashket me mjetin e kerkuar. Duke qene se mjeti i kerkuar ne kerkesat per kualifikim, referuar edhe specifikimeve teknike te ngarkuara ne sistem, eshte i domosdoshem per realizimin e punes sipas teknologjise se re te parashikuar ne projekt, ky bashkim shoqerish nuk mund ta kryeje punen qe tenderohet.

Bashkimi i shoqerive ka paraqitur nje oferte me vlere 247.709.531 leke pa tvsh, nderkohe qe pas kontrollit aritmetik dhe korigjimit te gabimeve aritmetike rezultoi se vlere e ofertuar eshte 252.958.446 leke. Vlere absolute e gabimit aritmetik eshte 5.248.914 leke ose 2,12%, me e madhe se 2%. Bazuar ne nenin 66, pika 4 te VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ku, nder te tjera, citohet: *“Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumtat absolute të të gjitha korigjimeve janë më shumë se $\pm 2\%$ e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar”* oferta e ketij bashkimi shoqerish refuzohet.

Duke qene se keto te meta jane thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete bashkim shoqerish.

3. Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomike “Lala” shpk (34%), “ED Konstruksion” shpk (30%), “Jody Company” shpk (6%) dhe “Shansi Invest” shpk (30%) pasi:

Bashkimi i Operatoreve Ekonomike nuk ploteson kerkesen 2.3.9 dhe 2.3.10 per kualifikim lidhur me



FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
ALBANIAN DEVELOPMENT FUND

disponimin e mjeteve dhe paisjeve, pasi nuk disponon mjetin “Mikser Rrotullues (Rotary Mixer)”. Ne vend te paisjes se kerkuar ne specifikimet teknike per kete qellim, shoqeria “Lala” shpk, pjese e bashkimit, ka paraqitur mjetin DBM 3000 qe eshte nje betoniore kantieri e cila nuk ka asgje te perbashket me mjetin e kerkuar. Duke qene se mjeti i kerkuar ne kerkesat per kualifikim, referuar edhe specifikimeve teknike te ngarkuara ne sistem, eshte i domosdoshem per realizimin e punes sipas teknologjise se re te parashikuar ne projekt, ky bashkim shoqerish nuk mund ta kryeje punen qe tenderohet.

Duke qene se kjo e mete eshte thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete shoqeri.

4. Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomike “B 93” shpk (45%), “Riviera” shpk (35%) dhe “Boshnjaku B” shpk (20%) pasi:

Shoqeria “Riviera” shpk nuk ploteson kerkesen 2.2.2 per kualifikim ku citohet: “Operatori Ekonomik duhet te kete nje aktivitet pozitiv (te mos kete dale me humbje) te qendrueshem gjate tre viteve 2015, 2016 dhe 2017. Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese kopje te bilanceve te ketyre tre viteve, te paraqitur pranë autoritetit përkatëse, te shoqeruara nga akt ekspertiza e kryer nga Eksperti kontabel i autorizuar” pasi eshte me humbje ne vitin 2017 ne shumen 12.749.241 leke. Ne daten 29.01.2019 kjo shoqeri ka dorezuar ne protokoll nje bilanc te rivleresuar te vitit 2017 sipas te cilit kjo shoqeri nuk figuron me humbje. Komisioni konstaton se rivleresimi nga tatimet eshte bere ne daten 11.01.2019, pas dates se hapjes se ofertave. Komisioni ju referua pikes 1 “Shqyrtimi i ofertave” te nenit 53 te Ligjit Nr. 9643 “Per Prokurimin Publik”, datë 20.11.2006, i ndryshuar, ku citohet: *“Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në nenet 32 dhe 33 të këtij ligji, nuk duhet të kërkohet, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme”*. Nisur nga ky kufizim i ligjit komisioni gjykon se nuk mund te marre parasysh bilancin e rivleresuar por vetem bilancin e ngarkuar ne sistemin elektronik te prokurimit.

Shoqeria “Riviera” shpk nuk ploteson kerkesen 2.2.3 per kualifikim lidhur me detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, pasi nuk ka paraqitur mandat pagesat per shlyerjen e detyrimeve vendore ne Korce, ku ka kryer aktivitet ne realizimin e objektit **“Rehabilitimi ne kanalet ujitëse sekondare te rezervuarit Gjanç”**, referuar buletinit 49, viti 2017, faqe 107 dhe buletinit 51, viti 2017, faqe 167. Po ashtu kjo shoqeri ka kryer aktivitet dhe nuk ka paraqitur mandat pagesat per shlyerjen e detyrimeve vendore ne Durres per vitin 2017 ku ka punuar per zbatimin e objektit “Shkolla 9 vjecare Marie Kaculini”, Berat per vitin 2017 ku ka punuar per zbatimin e objektit “Ujesjellesi Qereshnik”, Peqin per vitin 2018 ku ka punuar per zbatimin e objektit “Shkolla Demir Godelli”, Delvine per vitin 2018 ku ka punuar per zbatimin e objektit “Fusha e Futbollit Delvine”, Ballsh per vitin 2018 ku ka punuar per zbatimin e objektit “Shkolla Beselidhja”, Korce per vitin 2017 ku ka punuar per zbatimin e objektit “Ruga Korce Gorice”, Kavaje per vitin 2017 ku ka punuar per zbatimin e objektit “Ruga xhami”.

Shoqeria “Riviera” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.4 per kualifikim lidhur me stafin e inxhinierëve, pasi



FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
ALBANIAN DEVELOPMENT FUND

ka marre persiper te kryeje punime per shtresa rrugore dhe nuk ka te punesuar inxhinier ndërtimi me profilin transport, i domosdoshem per kryerjen e keture punimeve.

Shoqeria “B 93” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.4 per kualifikim lidhur me stafin inxhinierik, pasi, referuar cv –se se paraqitur ne tender, inxhinieri elektrik Fatmir Brati eshte i dypunesuar pasi eshte i punesuar njekohesisht ne Fakultetin e Inxhinierise Elektrike te Universitetit Politeknik te Tiranes, ne kundershtim me kreun IV, pika 2 te VKM Nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” ku nder te tjera citohet: *“Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike”*.

Ne kete menyre, duke qene se sipas marreveshjes se bashkepunimit ka marre persiper punime elektrike, kjo shoqeri nuk ploteson edhe piken 2.3.6 per kualifikim lidhur me mosangazhimin e inxhinierëve pasi, duke qene i punesuar ne Fakultetin e Inxhinierise Elektrike te Universitetit Politeknik te Tiranes nuk mund te qendroje ne objekt gjate gjithë kohes.

Bashkimi i shoqerive nuk ploteson kerkesen 2.3.9 per kualifikim lidhur me mjetet dhe paisjet qe duhet te kete ne dispozicion per kryerjen e punimeve, pasi mjetet e marra me qera nga shoqeria “B 93” shpk me targa AA203RC, AA431LC, AA069HS, AA032UB, AA830LT, AA460DN, AA461NI dhe mjetet e marra me qera nga shoqeria “Riviera” shpk me targa AA241DN, AA206NJ, TR6403U, AA145CZ dhe TR7812S kane te shenuar ne lejen e qarkullimit se jane per perdorim vetjak. Referuar Ligjit 8378, date 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikes se shqiperise”, Pjesa II, Neni 81 “Destinacioni dhe perdorimi i mjeteve” pikat 1,2,3,4,5 dhe 7,8 percaktohet sa me poshte:

“Me destinacion të mjetit nënkuptohet përdorimi i tij në bazë të karakteristikave teknike.

Me përdorim të mjetit nënkuptohet shfrytëzimi i tij ekonomik.

Mjetet mund të caktohen për përdorim vetjak ose për përdorim nga të tretët.

Quhet përdorim nga të tretët kur mjetet shfrytëzohen, kundrejt pagesës përkatëse, nga persona të tjerë të ndryshëm nga titullari i lejes së qarkullimit. Për rastet e tjera nënkuptohet përdorimi vetjak i mjetit.

Përdorimi nga të tretët përfshin: a) dhënien me qira pa drejtues mjeti; b) dhënien me qira me drejtues mjeti dhe shërbimi taksi për transport njerëzish; c) shërbimin e linjës për transport pasagjerësh; d) shërbimin e transportit të mallrave për llogari të të treteve; e) shërbimin e linjës për transportin e mallrave; f) shërbimin taksi për transportin e mallrave për llogari të të treteve”.

Pra sa më sipër ligjvenesit ka percaktuar se ne rastet kur mjeti jepet me qera ne lejen e qarkullimit destinacioni i mjetit duhet te jete e percaktuar qe mjeti te jepet per perdorim nga të tretet. Në të gjitha rastet e tjera mjeti eshte per perdorim vetjak dhe nuk mund te perdoret nga persona të tjere te ndryshem nga titullari i lejes se qarkullimit kundrejt pageses. Në të tilla raste ligjvenesit ne piken 8 percakton sanksione sipas pikes 8 ku specifikisht citohet: *“.....cilido që shfrytëzon një mjet me një destinacion ose për një përdorim të ndryshëm nga ato të treguara në lejen e transportit, ndëshkohet me masë administrative me gjobë nga pesë mijë deri në njëzet mijë lekë.”*

Pra, bazuar ne sa me siper, rezulton se keto mjete jane me destinacion perdorim vetjak dhe nuk mund te perdoren nga te trete pasi bie ne kundershtim me legjislacionin ne fuqi. Mjetet e mesiperm nuk mund te konsiderohen te rregullt nga komisioni i vleresimit te ofertave. Ky arsyetim mbeshtetet edhe ne Vendimin e Komisionit te Prokurimit Publik nr. 577 te vitit 2015, si dhe ne Vendimin e Komisionit te Prokurimit Publik nr. 296 te vitit 2016.

Duke qene se keto mjete jane te domosdoshem komisioni gjykon se ky bashkim shoqerish nuk e ploteson kete kerkese per kualifikim.

Duke qene se keto te meta jane thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete bashkim shoqerish.

5. Te skualifikoje Operatorin Ekonomik “Gjoka Konstruksion” shpk pasi:

Nuk ploteson kerkesen 2.3.4 per kualifikim lidhur me stafin inxhinierik, pasi inxhinierët Suada Vathi (inxhinier ndertimi), Koco Birbo (inxhinier mekanik), Sokol Dobra (inxhinier ndertimi me profilin transport) dhe Ardino Halimi (inxhinier ndertimi), te deklaruar ne kete procedure prokurimi, janë të deklaruar e te angazhuar në tenderin e punimeve me objekt : “Ndertim i rruges Kardhiq Delvine, loti 4”, lidhur me Autoritetin Rrugor Shqiptar, me vlere te kontrates 2.359.623.275 leke pa tvsh. Punimet per kete rruge kane filluar ne daten 24.09.2018 dhe afati per perfundimin e tyre eshte 24 muaj. Per kete informacion komisioni ju referua shkreses 50/2 Prot date 04.02.2019 derguar nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Nuk ploteson kerkesen 2.3.4 per kualifikim lidhur me deklarimin si te pa angazhuar te inxhinierëve te stafit qe do te kryeje punimet, pasi deklarata e paraqitur permban informacion te rreme.

Nuk ploteson kerkesen 2.3.9 dhe 2.3.10 per kualifikim lidhur me disponimin e mjeteve dhe paisjeve, pasi mjetet: AA736UB, AA738UB, AA739UB, AA740UB, AA667RH, AA668RH, AA669RH, AA102RL, TR8964N, rrul asfalti me goma S/N68890102 DHE rrul Dynpac gome hekur SN1000133ENA018998, te deklaruar ne kete procedure prokurimi janë të angazhuar në tenderin e punimeve me objekt : “Ndertim i rruges Kardhiq Delvine, loti 4”, lidhur me Autoritetin Rrugor Shqiptar, me vlere te kontrates 2.359.623.275 leke pa tvsh. Punimet per kete rruge kane filluar ne daten 24.09.2018 dhe afati per perfundimin e tyre eshte 24 muaj. Per kete informacion komisioni ju referua shkreses 50/2 Prot date 04.02.2019 derguar nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Nuk ploteson kerkesen 2.3.10 per kualifikim lidhur me deklarimin si te pa angazhuar te mjeteve qe do te perdoren per kryerjen e punimeve, pasi deklarata e paraqitur permban informacion te rreme.

6. Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomike “Delta Lavori” shpk (80%) dhe “Company Riviera 2008” shpk (20%) pasi:

Shoqeria “Delta Lavori” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.9 per kualifikim lidhur me mjetet dhe paisjet qe duhet te kete ne dispozicion per kryerjen e punimeve.

Referuar marreveshjes se bashkepunimit, shoqeria “Delta Lavori” shpk ka marre persiper totalisht punime prishje, punime germimi ne trupin e rruges, punime shtresash rrugore, punime ne trotuare, punime per ndricimin rrugor, punime gjelberimi, punime sinjalistike rrugore.

Shoqeria “Company Riviera 2008” shpk ka marre persiper totalisht punime per tombino, punime struktura betoni dhe punime ne KUB dhe per realizimin e ketyre punimeve shoqeria “Delta Lavori” shpk duhet te dispononte kamione veteshkarkues, kamioncina, gurethyes (frantoje), fabrike asfalti, impiant automatik betoni, autobitumatrice, asfaltoshtruese, rrul gome hekur, rrul hekur hekur, rrul asfalti gome gome, autobot uji, autobetoniera dhe fadrome. Kjo shoqeri, referuar deklaratës mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10, disponon vetem 2 ekskavatore me zinxhire, 1 ekskavator me goma, 1 greider, 1 rrul gome hekur me gunga, 2 kompresore, 1 freze asfalti, 1 autovinc dhe nje mikser rrotullues te cilin e ka me qera. Duke patur parasysh ndarjen e puneve sipas marreveshjes se



FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
ALBANIAN DEVELOPMENT FUND

bashkepunimit, nuk disponon kamione veteshkarkues, kamioncina, gurethyes (frantoje), fabrike asfalti, impiant automatik betoni, autobitumatrice, asfaltoshtuese, rrul gome hekur, rrul hekur hekur, rrul asfalti gome gome, autobot uji, autobetoniera dhe fadrome.

Operatorët ekonomikë “Delta Lavori” s.p.a & “Company Riviera” sh.p.k. kanë krijuar bashkimin e përkohshëm të shoqërive me anë të akt-marrëveshjes të lidhur para një noteri Nr.10531 Rep., datë 14.11.2018 Nga shqyrtimi i marrëveshjes së bashkëpunimit midis të tjerash rezulton se “ [...] **Operatorët ekonomikë, pjesë e kësaj kontrate, ranë dakord se mund të përdorin mjetet e njëri –tjetrit, pa kundërshpërblim, të nevojshme për realizimin e kësaj kontrate, sipas zërave të punës që ka marrë secila prej tyre për ndarjen e punimeve**[...]”

Në Kreun VIII, neni 74, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”.

Në Kreun VIII, neni 74, pika 2 po këtui, parashikohet: “Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen 68 përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi...”, ndërsa në pikën 3 parashikohet: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

KVO verën se përcaktimi “**Operatorët ekonomikë, pjesë e kësaj kontrate, ranë dakord se mund të përdorin mjetet e njëri –tjetrit, pa kundërshpërblim, të nevojshme për realizimin e kësaj kontrate, sipas zërave të punës që ka marrë secila prej tyre për ndarjen e punimeve**” është i një natyre përgjithëse, dhe nuk specifikon në mënyrë konkrete cilet janë mjetet që mund të përdorin në mënyrë të ndërsjellë anëtarët e BoE, në mënyrë që të mundësojë Autoritetit Kontraktor të vlerësojë nëse secili prej anëtarëve të BoE e plotëson kriterin për disponimin e mjeteve.

Në kushtet kur akt marrëveshja është lidhur në total dhe në tërësi, pa u detajuar apo ndarë se cilat mjete kanë në dispozicion secili prej anëtarëve të BoE, ky bashkim operatorësh ekonomikë nuk ka arritur të vërtetojë me dokumentacion përmbushjen e kriterit për mjetet, në përputhje me pjesët e punëve të marra përisht.

Sa më sipër, dokumentacioni i paraqitur në lidhje me përmbushjen e kriterit për mjetet, nuk është në përputhje me kërkesën e përcaktuar në dokumentat e tenderit, si edhe me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga BoE për plotësimin e kriterit të vendosur nga AK për disponimin e mjeteve, midis të tjerash rezulton se Company Riviera sh.p.k (anëtare e BoE) ka dorëzuar disa kontrata huapërdorimi pasurie të luajtshme.

Nga shqyrtimi i këtyre kontratave huapërdorimi, nuk rezulton se huadhënësit të kenë dhënë pëlqimin e tij për dhënien e mjeteve një të treti.

Në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, neni 903 përcaktohet se: “Huamarrësi detyrohet ta mbajë dhe ta ruajë sendin me përkujdesje. Ai nuk mund ta përdorë atë ndryshe nga përdorimi i caktuar në



FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
ALBANIAN DEVELOPMENT FUND

kontratë ose nga natyra e sendit. **Huamarrësi nuk mund t'ia japë një të tretë sendin për përdorim pa pëlqimin e huadhënësit.** Kur huamarrësi nuk përmbush detyrimet e lartpërmendura huadhënësi mund të kërkojë kthimin e menjëhershëm të sendit, përveç shpërblimit të dëmit.”

Në kushtet kur nuk është dhënë pëlqimi, Company Riviera sh.p.k nuk ka të drejtë ti japi për huapërdorje, të treteve (në rastin konkret Delta Lavori s.p.a) mjetet e parashikuara në kontratat e huapërdorjes.

Shoqeria “Company Riviera 2008” shpk nuk ploteson kërkesen kërkesen 2.3.6 për kualifikim lidhur me deklaratën për mos angazhimin e inxhinierëve pasi në deklarata shprehet se inxhinieret “do të jene të pa angazhuar në kontrata të tjera që operatori ekonomik ka aktualisht në proces zbatimi dhe, në rast se shpallen fitues për këtë procedurë, do të qëndrojnë në objekt gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve” dhe jo “jane të pa angazhuar në kontrata të tjera që operatori ekonomik ka aktualisht në proces zbatimi dhe, në rast se shpallen fitues për këtë procedurë, do të qëndrojnë në objekt gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve” sic kërkohej në kërkesën për kualifikim.

Shoqeria “Company Riviera 2008” shpk nuk ploteson kërkesen kërkesen 2.3.9 për kualifikim lidhur me mjetet dhe pajisjet që duhet të ketë në dispozicion për kryerjen e punimeve, pasi dokumentacioni për marrjen me qera të mjeteve nga “Company Bejta Commerce” sha, me seli në Kosovë, është i pa apostiluar në përputhje me ligjin.

Gjithashtu mjetet autobetoniere me targe TR 5385 P dhe TR 9342 M, të marra me qera nga shoqeria “Sina 98” shpk, kanë të shënuar në lejen e qarkullimit se janë për përdorim vetjak. Referuar Ligjit 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, Pjesa II, Neni 81 “Destinacioni dhe përdorimi i mjeteve” pikat 1,2,3,4,5 dhe 7,8 përcaktohet sa më poshtë:

“Me destinacion të mjetit nënkuptohet përdorimi i tij në bazë të karakteristikave teknike.

Me përdorim të mjetit nënkuptohet shfrytëzimi i tij ekonomik.

Mjetet mund të caktohen për përdorim vetjak ose për përdorim nga të tretët.

Quhet përdorim nga të tretët kur mjetet shfrytëzohen, kundrejt pagesës përkatëse, nga persona të tjerë të ndryshëm nga titullari i lejes së qarkullimit. Për rastet e tjera nënkuptohet përdorimi vetjak i mjetit.

Përdorimi nga të tretët përfshin: a) dhënien me qira pa drejtues mjeti; b) dhënien me qira me drejtues mjeti dhe shërbimi taksi për transport njerëzish; c) shërbimin e linjës për transport pasagjerësh; d) shërbimin e transportit të mallrave për llogari të të treteve; e) shërbimin e linjës për transportin e mallrave; f) shërbimin taksi për transportin e mallrave për llogari të të treteve”.

Pra sa më sipër ligjvënisi ka përcaktuar se në rastet kur mjeti jepet me qera në lejen e qarkullimit destinacioni i mjetit duhet të jetë e përcaktuar që mjeti të jepet për përdorim nga të tretët. Në të gjitha rastet e tjera mjeti është për përdorim vetjak dhe nuk mund të përdoret nga persona të tjerë të ndryshëm nga titullari i lejes së qarkullimit kundrejt pagesës. Në të tilla raste ligjvënisi në pikën 8 përcakton sanksione sipas pikës 8 ku specifikisht citohet: “.....cilido që shfrytëzon një mjet me një destinacion ose për një përdorim të ndryshëm nga ato të treguara në lejen e transportit, ndëshkohet me masë administrative me gjobë nga pesë mijë deri në njëzet mijë lekë.”

Pra, bazuar në sa më sipër, rezulton se këto mjete janë me destinacion përdorim vetjak dhe nuk mund të përdoren nga të trete pasi bie në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Mjetet e mesipër nuk mund të konsiderohen të rregullt nga komisioni i vlerësimit të ofertave. Ky arsyetim mbështetet edhe në Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr. 577 të vitit 2015, si dhe në Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr. 296 të vitit 2016.

Duke qenë se këto mjete janë të domosdoshëm (pasi kjo shoqëri ka marrë përsipër punime betoni)



FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
ALBANIAN DEVELOPMENT FUND

komisioni gjykon se kjo shoqeri nuk e ploteson kete kerkese per kualifikim.

7. Te skualifikoje Operatorin Ekonomik “Alba Konstruksion” shpk pasi:

Nuk ploteson kerkesen 2.3.9 dhe 2.3.10 per kualifikim lidhur me disponimin e mjeteve dhe paisjeve, pasi nuk disponon mjetin “Mikser Rrotullues (Rotary Mixer)”. Ne shtojcen 9 ka deklaruar se disponon kete mjet sipas kontrates se qerese nr. 395 Rep dhe nr. 113 kol, date 24.02.2017. Komisioni shqyrtoi kete kontrate te lidhur me shoqerine “Kalivjoti” shpk dhe konstatoi se nuk eshte marre me qera asnje mjet i tille.

Duke qene se kjo e mete eshte thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete shoqeri.

8. Te skualifikoje Operatorin Ekonomik “4 AM” shpk pasi:

Ne daten 21.12.2018, me shkresen nr. 1635 prot, kjo shoqeri ka deklaruar se terhiqet nga procedura e tenderit.

9. Te skualifikoje Operatorin Ekonomik “Be Is” shpk pasi:

Ne daten 24.01.2019, me shkresen nr. 152 prot, kjo shoqeri ka deklaruar se terhiqet nga procedura e tenderit.

10. Te skualifikoje Operatorin Ekonomik “Curri” shpk pasi:

Nuk ploteson kerkesen 2.3.9 dhe 2.3.10 per kualifikim lidhur me disponimin e mjeteve dhe paisjeve, pasi nuk disponon mjetin “Mikser Rrotullues (Rotary Mixer)”.

Duke qene se kjo e mete eshte thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete shoqeri.

11. Te skualifikoje Operatorin Ekonomik “Vellezerit Hysa” shpk pasi:

Nuk ploteson kerkesen 2.3.9 dhe 2.3.10 per kualifikim lidhur me disponimin e mjeteve dhe paisjeve, pasi nuk disponon mjetin “Mikser Rrotullues (Rotary Mixer)”. Ne vend te paisjes se kerkuar ne specifikimet teknike per kete qellim, ka paraqitur nje betoniere e cila nuk ka asgje te perbashket me mjetin e kerkuar.

Duke qene se kjo e mete eshte thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete shoqeri.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **“Alb Tiefbau” sh.p.k**, me NIPT J66703049C, me adrese: Lagjja Qemal Stafa, Rruga Studenti, Sheshi 2-Prilli, pallati Fishta 2, zona kadastrale 8591, nr pasurie 2/988-N8, Shkodër, se oferta e paraqitur, me vlerë **316,628,785 (treqind e gjashtëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e njëzet e tetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e pesë) lekë** pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Autoritetit Kontraktor:**

- **Fondi Shqiptar i Zhvillimit**
- **Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 10, Tirana, Albania**
- **Phone: 00355 4 2 235 597/8 (int.151)**
- **Fax: 00355 4 2 234 885**

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda pese ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **04.02.2019**.

Ne datën 12.02.2019 paraqiti ankimi BoE “Lala” sh.p.k & “Shansi Invest” sh.p.k & “Ed Konstruksion” sh.p.k & “Jody Company” sh.p.k. Ankimit ju kthye pergjigje ne daten 18.02.2019 duke e refuzuar ate.